

2 **Gastronomia-Hoteleria**
Nga viti 2019 pagat rriten për 1,3%

3 **Luca Ciriliano**
mbi iniciativën anti-njerëzore

4 **Diaspora për zhvillim**
Bashkëpunim konkret Zvicër – Kosovë

Nr. 5 | shtator 2018 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Masat shoqëruese dhe mbrojtja e pagave «Ministrat federalë të FDP-së sulmojnë pagat tona»



Pamje nga demonstrata e muajit qershor 2018 e punëtorëve të ndërtimtarisë për mbrojtjen dhe avancimin e të arriturave të tyre

Bisedimet midis partnerëve socialë mbi marrëveshjen kornizë me BE-në kanë dështuar. Sindikatat nuk po marrin pjesë në bisedimet mbi masat shoqëruese të organizuara nga Ministri i Ekonomisë, Johann Schneider-Ammann. Ngase Këshilli Federal e venë në pikëpyetje mbrojtjen e pagave.

Zvicra po negocion një marrëveshje kornizë me BE-në. Për këtë, Këshilli Federal ka përcaktuar një vijë të kuqe: se nuk do të diskutohen fare masat shoqëruese. Këto garantojnë që në Zvicër të paguhen paga zvicerane.

Këshilli Federal dëshiron ti shmanget mbrojtjes së pagave

Por Ministri i Jashtëm i FDP, Ignazio Cassis, dëshiron të zbutë këtë mbrojtje për punonjësit dhe ndërmarrësit lokalë dhe venë në pikëpyetje rregullin e ashtuquajtur 8-ditor. Ky rregull është një ndër pikat qendrore e masave shoqëruese mbrojtëse. Kjo rregull parasheh që kompanitë e BE-së duhet të raportojnë tetë ditë para se ato të fillojnë punën në Zvicër. Kështu inspektorët mund ta dinë, se ku duhet të kontrollojnë më së shumti.

Tradhti ndaj të varurve nga pagat

Në emër të Këshillit Federal, Ministri i Ekonomisë Johann Schneider-Ammann (FDP) do të duhej të shqyrtonte risitë eventuale teknike të masave shoqëruese. Njerëzit e tij përpiluan një letër ku ata vunë në pikëpyetje mbrojtjen e pagave dhe të gjithë masat shoqëruese mbrojtëse. Reagimi i kryetarës së Unia Vania Alleva: «Schneider-Ammann vë gjithçka në lojë: rregullin 8-ditor, detyrimin e depozitimit, sanksionet kundër punëdhënësve të rremë, luftimin e vetëpunësimit fals dhe cilësisë dhe sasisë së inspektimeve të paritetit të punës. Ky është një sulm i përgjithshëm në thelbin e masave shoqëruese mbrojtëse dhe kështu edhe sulm kundër të drejtave të të gjithë punëtorëve në këtë vend.» Presidenti i BSZ (Bashkimit të Sindikatave Zvicerane), Paul Rechsteiner e thotë me pak fjalë: «Kjo

është tradhti politike vendore ndaj të varurve prej pagave!»

Bisedime pa sindikatat

Është e logjikshme që në këto rrethana sindikatat as që duan të ulen në tryezën e bisedimeve. Por pa sindikata, «negociatat» e Schneider-Ammann-it janë në të vërtetë muhabet i kot. Në to përfshihet vetëm një rreth i vogël: punëdhënësit dhe kantonet. Se a ka ndonjë kuptim që të «negociohet» pa punonjësit, kjo është mjaft e diskutueshme.

Të drejtat e punonjësve nuk janë të negociueshme

Për Vania Alleva është e qartë: «Minsitrat federal të FDP-së padyshim duan të përdorin negociatat mbi marrëveshjen kornizë për të dobësuar të drejtat e punonjësve. Me masat shoqëruese mbrojtëse, kemi fituar të drejta sindikale që ndihmojnë në frenimin e ekseleve më të këqija të shfrytëzimit në vendin tonë. Nuk është për tu çuditur, se kjo nuk u pëlqen të gjithë rrjepësve dhe atyre që ndjekin linja të ashpra neo-liberale, sipërmarrësve që ushtrojnë dumping në

pagina dhe urryesve të sindikatave.» Por për sindikatat, shkurtimet e të drejtave të punonjësve nuk janë të negociueshme.

Lëvizja e lirë e personave dhe masat shoqëruese mbrojtëse janë të arritura të mëdha

Për Unia, lëvizja e lirë e personave është një e arritur e madhe. Vania Alleva: «Para lëvizjes së lirë të personave ne kishim statutin degradues të punëtorëve sezonal plus kontingjentet. Fakti që e kemi kapërcyer këtë është një sukses i madh. Masat shoqëruese anësore janë një mbrojtje jo-diskriminuese dhe sjellin përmirësime për të gjithë punëtorët. Sa më shumë të kemi të drejta të punëtorëve, aq më pak të shfrytëzueshëm janë ata. Masat shoqëruese anësore i mbrojnë më mirë kushtet tona të punës sesa kontingjentet dhe diskriminimi. Lëvizja e lirë e personave plus masat shoqëruese mbrojtëse: kjo është rruga e drejtë, të cilën ne urgjentisht duhet të përmirësojmë më tej.»

Clemens Studer,
work (përshtatur nga Marília Mendes)

Editorial



Lufta jonë vazhdon më tej – #Enough!

Demonstrata e ndërtimtarisë në qershor ishte një sukses i plotë – me rreze dielli dhe me 18000 punëtorë të zëshëm dhe të angazhuar ndërtimtarie. Falënderime të përzemërta të gjithë pjesëmarrësve – kjo është inkurajuese. Pronarët e ndërtimit ende nuk e kanë ndier sa duhet, mirëpo ne arritëm të shtojmë dukshëm presionin dhe ata kanë vërejtur se ka vetëm një zgjidhje me Unia sa i përket pensionimit më 60 vjet. Gjithashtu se është koha e fundit për një rritje pagash!

Dhe tani vijojmë më tej: Më 22 shtator në Bernë zhvillohet demonstrata e madhe për barazinë në paga dhe kundër diskriminimit. Me mijëra gra (dhe burra) do të demonstrojnë, për të zbatuar në Zvicër më në fund barazinë në paga. Gratë edhe më tej fitojnë 1/5 më pak se sa burrat – punëdhënësit në kurriz të grave kursejnë me miliona, përditë dhe pa u ndëshkuar! Unia ka gjetur që nga kjo, në jetën e tyre gratë në kuletën e tyre kanë 303000 franga më pak – këtë gjendje gratë nuk do ta tolerojnë me tej. Mjaftë më! Barazi në paga tani! Në Gjenevë ndodhi një sulm brutal ndaj grave – ato janë rrahur dhe bërë për spital. Kjo nuk është rastësi! Mjaft më me ngacmime dhe dhunë, paga të ulëta të grave, punë me kohë të kufizuar minimale dhe stres në vendin e punës. Andaj do të demonstrojmë të gjithë ne me 2 shtator!

Corinne Schärer



#Enough18
Demonstration
am 22.9.2018 in Bern
22. September, 13.30 Uhr,
Schützenmatte

News

PO për Iniciativën e të ushqyerit të drejtë (Fair-Food)!

Bujqësia e qëndrueshme është ankoruar dukshëm në kushtetutë. Ajo deri më tani nxitet me pagesa të drejtpërdrejta. Këto janë të lidhura me provën ekologjike të arritjeve. Veçanërisht duhet të shpërblehen dhe të kompensohen në mënyrë plotësuese për metodat e prodhimit dhe ato mjedisore të mbajtjes së kafshëve afër të natyrshmes, në mënyrë që familjet e fermerëve të jenë në gjendje të arrijnë të ardhura të arsyeshme me prodhim të qëndrueshëm. Iniciativa e ushqimit të drejtë dëshiron të forcojë furnizimin me ushqim ekologjikisht miqësor duke përfshirë edhe fuqizimin e importin e prodhimit dhe tregtimit korrekt. Andaj PO:

- për një bujqësi ekologjike (mjedisore/ambientaliste) e rajonale!
- për një kultivim të përshtatshëm dhe të drejtë të kafshëve!
- për tregti korrekte në vend të tregtisë së pakufizuar të lirë!

WAS IST DIE FAIR-FOOD-INITIATIVE?

Die Bundesverfassung wird wie folgt geändert:

Art. 104a Lebensmittel

Die Bund stärkt das Angebot an Lebensmitteln, die von guter Qualität und sicher sind und die umwelt- und ressourcenschonend, tierfreundlich und unter fairen Arbeitsbedingungen hergestellt werden. Er legt die Anforderungen an die Produktion und die Verarbeitung fest.

Er stellt sicher, dass eingeführte landwirtschaftliche Erzeugnisse, die als Lebensmittel verwendet werden, grundsätzlich mindestens den Anforderungen nach Absatz 1 genügen. Für solche verarbeitete und zusammengesetzte Lebensmittel sowie für Futtermittel stellt er dieses Ziel an. Er begünstigt eingeführte Erzeugnisse aus fairem Handel und bodenbewirtschaftenden bäuerlichen Betrieben.

Er sorgt dafür, dass die negativen Auswirkungen des Transports und der Lagerung von Lebens- und Futtermitteln auf Umwelt und Klima reduziert werden.

Er hat insbesondere folgende Befugnisse und Aufgaben:

- Er erlässt Vorschriften zur Zulassung von Lebens- und Futtermitteln und zur Deklaration von deren Produktions- und Verarbeitungsweg.
- Er kann verbindliche Zielvereinbarungen mit der Lebensmittelbranche, insbesondere mit Importeuren und dem Detailhandel, abschließen.
- Er fördert die Verarbeitung und die Vermarktung regional und saisonal produzierter Lebensmittel.
- Er trifft Massnahmen zur Eindämmung der Lebensmittelverschwendung.

Die Bundesrat legt mittel- und langfristige Ziele fest und erlässt entsprechende Beschlüsse über den Stand der Zielerreichung. Werden diese Ziele nicht erreicht, so trifft er zusätzliche Massnahmen oder verstärkt die bestehenden.

Art. 190, Ziff. 10

10. Übergangsbestimmung zu Artikel 104a (Lebensmittel)

Till setzt drei Jahre nach Annahme von Artikel 104a durch den Volk und Stände ein Ausführungsrecht in Kraft, so erlässt die Bundesrat die Ausführungsbestimmungen auf dem Verordnungsweg.

FAIR-FOOD-INITIATIVE
www.fair-food.ch

FAIR FOOD JA

Bisedimet për pagat në Gastronomi Pagat minimale në vitin 2019 rriten për 1,3%



Puna në degën e gastronomisë-hotelerisë duhet të shpërblehet meritueshëm

Pagat minimale në industrinë e gastronomi-hotelerisë do të rriten me 1 deri në 1,3% nga 1 janari 2019. Kjo është ajo që partnerët socialë në industrinë e hotelerisë kanë rënë dakord. Palët kontraktuese nga ana e punëmarrësve janë: Unia, Syna dhe Hotel & Gastro Union; ndërsa nga ajo e punëdhënësve: GastroSuisse, hotelleriesuisse dhe Shoqata Zvicerane Catering SCA.



Çdo vit, sindikatat dhe punëdhënësit negociojnë paga minimale për industrinë e gastronomisë dhe hotelerisë. Deri në vitin 2019, ata kanë rënë dakord të rrisin pagën minimale për të gjitha kategoritë e pagave me 1 deri në 1,3%.

Pagat minimale 2019

Kategoria e pagave	Pagat minimale aktuale	nga 1.1.2019
Ia, pa arsimim profesional	Fr. 3435.–	Fr. 3470.–
Ib, me Progresso (5 javë)	Fr. 3637.–	Fr. 3675.–
II, me Attest-profesional	Fr. 3737.–	Fr. 3785.–
IIIa, me arsimim profesional (3 vite)	Fr. 4141.–	Fr. 4195.–
IIIb, me aftësim profesional + 6 ditë trajnim	Fr. 4243.–	Fr. 4295.–
IV, me provim profesional	Fr. 4849.–	Fr. 4910.–
Praktikant/e	Fr. 2190.–	Fr. 2212.–

Pagat më të mira në sajë të L-GAV

Kontrata Kolektive Kombëtare e Punës së Gastronomisë / Hotelerisë (K-KKP) u garanton punonjësve një pagë minimale sipas arsimimit dhe përvojës profesionale. Ajo përcakton që pagat minimale do të ri-negociohen çdo vit. Një Kontratë e mirë Kolektive Kombëtare e Punës (K-KKP) nuk pikë nga qielli. Falë sindikatave, tani ekziston një K-KKP për gastronominë dhe industrinë e hoteleve, dhe me këtë edhe pagat minimale dhe paga e 13-të mujore për të gjithë.

Këshilla për Punonjësit e Gastronomisë

Kërkoni nga punëdhënësi juaj një kontratë pune me shkrim. Ju mund të thirrreni në këtë të drejtë, për shembull, nëse duhet të bëni orë të papaguara pune jashtë orarit, nëse nuk respektohen periudhat e pushimit ose nëse merrni pagesë shumë të vogël. Mirë të dini: Kontrata juaj e punës mund ta shqyrtoni në sekretarin Tuaj të Unia përpara se ta nënshkruani atë.

Komunikata për media e Unia (përshtatur nga Osman Osmani)

Firmat temporale

Kontrata Kolektive e Punës (KKP) mbi personelin e huazuar është në fuqi që nga 1 maji 2016, me vlefshmëri deri në fund të vitit 2018. Në KKP 2016, sindikatat me shoqatën e punëdhënësve «swissstaffing» arritën të negociojnë paga minimale më të mira. KKP nga Qeveria Federale është deklaruar përgjithësisht e detyrueshme dhe zbatohet për të gjithë huadhënësit e personelit (kompanitë temporale) pavarësisht nga madhësia dhe dega e industrisë. KKP për personelin e huazuar vlen për rreth 315000 punonjës të përkohshëm (temporal). Vega e mëposhtme ju çon tek Kontratat e tanishme Kolektive të Punës (KKP) me kushtet e aplikueshme të punës në industrinë tuaj: www.gav-service.ch/Search/Temporärfirmen

Greva 3-minutëshe në bizneset e hortikulturës në të gjithë Zvicrën gjermanofolëse

Një premierë zvicerane: Pikërisht në orën 15:00 (më 19.07.2018), kopshtarët simbolikisht ndaluan punën e tyre për tre minuta në dhjetëra kantiere të Zvicrës gjermanofolëse. Kopshtarët e kanë lënë punën e tyre në dhjetëra biznese. Me grevën e parë «tre minutash» në hortikulturë, ata e bëjnë të qartë se kjo degë e industrisë duhet më në fund të dalë nga zona e pagës së ulët! Përgjegjës për këtë gjendje është shoqata e pronarëve kopshtarë «Jardin-Suisse».

Kompania e platformës

Kompania Uber tu ofrojë sigurim shoqëror (AHV/AVS) vozitësit/eve

Një raport i ri ligjor merret me statusin e sigurimeve shoqërore të shoferëve të shërbimeve Uber. Ky vlerësim vjen në përfundim se sipas ligjit të sigurimeve shoqërore shoferët janë jo të pavarur, prandaj ata duhet të trajtohen si punonjës të Uber-it.

Uber punon si ofrues i shërbimit të taksive në transportin e pasagjerëve, por punon me shoferët jo-profesionalë dhe të nën-siguruar. Pos kësaj Uber posedon disa App-oferta, përmes të cilave klientët mund të rezervojnë udhëtime.

Uber duhet të punësojë shoferët në mënyrë të rregullt

Deri tani, Uber trajton shoferët e tij si të vetëpunësuar fiktiv dhe refuzon të përmbushë detyrat e tij si punëdhënësi. Unia prej kohësh ka kërkuar nga Uber që korporata duhet të punësojë drejtuesit e saj siç duhet, t'i regjistrojë ata në sigurimet shoqërore dhe të paguajë kontributet e punëdhënësit në përputhje me ligjin.

Strategjia e Unia për digjitalizimin

Strategjia e dixhitalizimit të Unia ka përcaktuar pesë piste përgjatë të cilave ajo vepron: ekonomia e platformës dhe zbatimi i ligjit në fushën e punës dhe të sigurimeve shoqërore, ndalimi i shpërbërjes së punës, vazhdimi i arsimit / rikualifikimit, pjesëmarrja dhe privatësia. Në arsimin e mëtejshëm, Unia arriti suksesin e saj të parë të rëndësishëm në negociatat e KKP-së të industrisë MEM duke ankoruar miratimin profesional 4.0 në KKP. Kështu do të duhej siguruar financimi e rikualifikimi i punonjësve që humbasin punën e tyre për shkak të digjitalizimit. Një studim mbi arkëtimet e arkave-vetë-skanuese dhe shitjeve elektronike, është porositur nga Unia dhe ajo do të publikohet së shpejti. Ajo ka për qëllim të hedh dritë



Dorëzimi i peticionit kundër dumpingut në paga

mbi efektet që ka teknologjia në stafin e tregtimit me pakicë. Përkufizimi mes punës dhe jetës private është tema qendrore në fushatën kundër stresit dhe sulmet ndaj ligjit të punës. Sidoqoftë, fokusi i aktiviteteve të mëparshme të Unia përqendrohet tek zbatimi i ligjit të punës dhe të sigurimeve shoqërore në Uber dhe kompani të tjera platformash.

Vlerësimi

Në vlerësimin e porositur nga Unia, Prof. Dr. iur. Thomas Gächter dhe MLaw Michael E. Meier nga Instituti Juridik i Universitetit të Cyrihut përshkruajnë në detaje se në rastin e shoferëve Uber në Zvicër, sipas ligjit të sigurimeve shoqërore, kemi të bëjmë me marrëdhënie pune jo të pavarur. Në përgjithësi, sipas studimit, karakteristikat e marrëdhënies në punë tejkalojnë ato të punësimit të pavarur. Kjo do të thotë që Uber duhet të regjistrojë shoferët e tij tek sigurimet shoqërore (AHV/AVS, IV/AI, sigurimi i aksidenteve) dhe të paguajë kontributet e punëdhënësit

Beat Baumann (përshtatur nga Osman Osmani)

Ndërtimtaria: Kontrata kombëtare e punës dhe pensioni me 60 vjet Orar pune pa kufi – jo kurrsesi!

Kontrata kombëtare e Punës për ndërtimtarinë kryesore (LMV) përfundon në fund të vitit. Ajo rregullon pagat dhe kushtet e punës për të gjithë punëtorët e ndërtimtarisë në Zvicër. Sindikatat aktualisht janë duke negociuar me shoqatën e pronarëve të ndërtimit Kontratës e re kombëtare. Tani shoqata e pronarëve kërkon heqjen e rregullit të orarit të punës.

Me 23 qershor në Cyrih kanë demonstruar 18000 punëtorë të ndërtimtarisë nga të gjitha pjesët e Zvicrës për të siguruar pensionimin e mëhershëm me 60 vjet dhe për rritje pagash. Presioni i punëtorëve të ndërtimtarisë ka ndikuar: derisa për rreth një vit shoqata e pronarëve kundërshtonte bisedimet, tani ata kanë bërë ofertën e parë. Mirëpo, çfarë oferte! Pronarët e ndërtimit kërkojnë faktikisht heqjen e rregullit të orarit të punës: 50 orë në javë, 12 orë në ditë dhe 300 orë shtesë pune falas duhet të bëhen normale. Vetëm tek pensionimi i mëhershëm me 60 vjet ata janë të gatshëm për kompromis. Kështu ata tani kërkojnë vetëm një shkurtim përfitim prej 5%.

Pa një zgjidhje do të kemi një vjeshtë të nxehtë në kantiere

Për punëtorë të ndërtimtarisë është e qartë: Një rritje pagash dhe pensionimi me 60 vjet nuk ia vlen, nëse sëmuremi nga puna më gjatë, apo pësojmë aksident të rëndë para pensionimit. Shëndeti dhe jeta e punëtorëve të ndërtimtarisë nuk janë për tu blerë apo shitur! Durimit të punëtorëve të ndërtimtarisë po i vjen fundi. Rezultati i votimit mbi grevën, të cilin Unia e ka realizuar me rreth 20'000 punëtorë të ndërtimtarisë nëpër kantiere në gjithë vendin është e qartë: 93,1% e punëtorëve të ndërtimtarisë janë të gatshëm për grevë, nëse pronarët e ndërtimit nuk ofrojnë dorën për zgjidhje të vërtetë.

Lena Frank



Punëtorët e ndërtimtarisë të gatshëm edhe për grevë

Fushata e hotelerisë «Unë nuk do të ecja zbathur në këtë dhomë hoteli»

Të gjitha hotelet kanë emrat e tyre që tingëllojnë: Renaissance, Sheraton ose Marriott. Të gjitha këto hotele i përkasin zinxhirit amerikan të hoteleve Marriott – kompania më e madhe e hoteleve në botë. Përkundër fasadave të bukura, ato fshehin shumë të këqija.



Was Arbeitsbedingungen mit sauberen Hotelzimmern zu tun haben

Und was Hotels dagegen tun können.

Ein Report der Unia Zürich-Schaffhausen zur aktuellen Situation in Zürcher Marriott Hotels

Presioni i punës dhe dëmet shëndetësore

Punëtorët e pastrimit në një raport të sindikatës Unia tregojnë për situata rrëqethëse, kështu Petra* nga Hotel Sheraton thotë: «Ne duhet të pastrojmë gjithçka me të njëjtin mjet pastrimi. Mjeti është helmues. Do të duhej të përdorej vetëm në banjë dhe pastaj të shpëlahet me shumë ujë. Natyrisht, kjo nuk mund të bëhet në dysheme druri dhe në mobile. Unë nuk do të ecja zbathur në këtë dhomë hoteli.» Më e keqja për shumicën është presioni i madh i punës. Për pastrimin e një dhome në dispozicion janë vetëm 10 minuta, kohë kjo që nuk është e mjaftueshme. Maria* nga Hotel Renaissance flet për ditët kur shërbëtorët e dhomave duhej të punonin «deri në 19 orë».

Kujt i takojnë këto hotele?!

Si mund të mbretërojë kjo gjendje në këto hotele të shtrënjta? Pas markave të mirënjohura të hoteleve është një sistem i komplikuar. Hotelet nuk i përkasin Marriott por UBS ose Helvetia. Ato i lejojnë kompanitë e tjera të operojnë me hotelet, e si kompensim, për shkak të drejtës së emërtimit, tarifrat duhet të paguhet Marriott. Në fund fare janë kompanitë e pastrimit, të cilët i nënshtrohen një lufte e konkurrence të pamëshirshme të çmimeve. Cilësia dhe kushtet e mira të punës i takojnë të së kaluarës.

Mungesa e respektit

«Trajto të tjerët me respekt», thotë Kodi i Mirësjelljes i Marriott. Por, për aq kohë sa Marriott lejon për t'u shkelur të drejtat e punonjësve të hoteleve, këto janë premtime boshe. Marriott mund të zgjidhë problemet sot duke marrë përsipër punësimin e të gjithë personelit të pastrimit dhe kështu ti japi fund luftës shkatërruese të çmimeve. Vega tek raporti: rebrand.ly/reinigung

*Emrat e vërtetë i janë të njohur Unia, por janë ndryshuar për të mbrojtur njerëzit

Daniel Gähwiler, Duarte Pacheco, Sindikata Unia Cyrih-Shaffhausen

Intervistë me: Luca Cirigliano



Iniciativa kundër – drejtave njerëzore e SVP-së atakon të drejtat tona themelore

Më 25 nëntor 2018, elektorati zviceran voton për iniciativën e SVP-së «kundër gjyqtarëve të huaj». SVP banalizon ndikimin e kësaj nisme në sistemin ligjor zviceran dhe të drejtat tona themelore. Luca Cirigliano, jurist dhe sekretari qendror i BSZ-së, foli me Horizonte rreth pasojave të iniciativës.

Luca, SVP e quan iniciativën «iniciativë për vetëvendosje» ose «kundër gjyqtarëve të huaj». Për çka është fjala?

Kushtetuta duhet të jetë mbi të drejtën ndërkombëtare dhe të veprojë mbi këtë të fundit në rast konflikti. Iniciatorët pohojnë se e drejta ndërkombëtare do të ishte ligj i huaj që do «ti imponohet» Zvicrës. Kjo është e pakuptimtë. E drejta ndërkombëtare është e drejtë kontraktuale dhe secili shtet përcakton se cilin ligj dëshiron ta miratojë. Kështu, është edhe ligji zviceran. Por kjo nuk iu intereson iniciatorëve: ata duan të dobësojnë apo edhe të heqin mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Zvicër.

A është e drejtë që kundërshtarët e iniciativës të flasin për një «iniciativë kundër të drejtave të njeriut»?

Shumë e qartë. Sulmi i SVP qartë është kundër Konventës për të Drejtat e Njeriut dhe konventave të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Punë (ILO). Nëse iniciativa do të kalonte, Zvicra ndoshta do të duhej ti anulonte ato. Jo vetëm që kjo do të ishte shumë e keqe për imazhin e Zvicrës, por sulmi mbi të drejtat tona themelore do të ishte më i lehtë dhe do të bënte ato më të lëndueshme.

Pse SVP nis një iniciativë që është kundër të drejtave të njeriut?

E drejta ndërkombëtare është universale, ai shkon përpara çdo ligji dhe çdo kushtetute. Kjo nuk i përshtatet SVP-së. Sepse ajo në mënyrë të përsëritur bën kërkesa që vënë në dyshim të drejtat themelore. Ajo argumenton se kushtetuta garanton gjithashtu të drejtat themelore. Kjo është kështu, për shkak se konventat ndërkombëtare janë përkrahura në kushtetutë. Por ato mund të anulohen në çdo kohë nga një nismë popullore. Nëse largohet mbrojtja e të drejtave të njeriut, SVP-ja i hap vetes rrugën për iniciativat e saja anti-humane dhe anti-sociale.

A janë të prekur punonjësit nga iniciativa?

Plotësisht e qartë. SVP sulmon të drejtat e punëtorëve, edhe me këtë nismë: Punonjësit mbështeten në një sistem të mirëfillt të të drejtave të njeriut për të zbatuar interesat e tyre në raport me punëdhënësit. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe e drejta ndërkombëtare e ILO-s janë qendrore, ato u garantojnë të gjithë të punësuarve të drejta të ndryshme. Në Zvicër nuk ekziston një gjykatë kushtetuese që ndërhyr kur ligjet shkelin liritë tona të mbrojtura nga të drejtat themelore. Pa të drejta të njeriut, nuk ka të drejta të garantuara për punë dhe sindikata.

Dhe migrantët/et, a do të preken edhe ata/o nga iniciativa?

Po, edhe qëllimisht. Vet historia e iniciativës tashmë tregon: Shkaktari i iniciativës ishte një gjykim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me nismën e debimit. Pra, fjala ishte për të drejtat e migrantëve në Zvicër – gjegjësisht dëshira e SVP-së për t'i privuar ato. Përndryshe, të drejtat e njeriut janë veçanërisht të rëndësishme për migrantët. Kur bëhet fjalë për të drejtën e banimit, proporcionalitetin e lejeve të qëndrimit, natyralizimin... Të gjitha të drejtat e njeriut garantojnë të drejtat themelore të personit në fjalë.

Të drejtat e njeriut pra janë vendimtare sa i përket ligjshmërisë...

Pikërisht. Ato na mbrojnë në jetën e përditshme dhe në të gjitha fushat e jetës: ato na mbrojnë në vendin e punës; Ato garantojnë të drejtën për t'u organizuar në një ndërmarrje dhe për të shkëmbyer informacion; Ato sigurojnë trajtim të barabartë në sigurimet shoqërore; Falë tyre mund të kërkojmë të drejta të barabarta dhe pagë të barabartë... Gjithandëj dhe çdo ditë kemi nevojë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Marília Mendes

Ju pyesni, Unia përgjigjet

Shtesat e fëmijëve: A i lejohet ish burrit tim të ma faturojë pagesën e mirëmbajtjes?

Ish burri im dhe unë kemi një vajzë të përbashkët. Unë si e vetme kam të drejtën e përkujdesjes. Ish burri im, sipas dekretit gjyqësor të divorcit, duhet të më paguaj për përkujdesjen e vajzës. Tanimë unë jam rimartuar dhe sapo jam bërë përsëri nënë. Unë, në fund të pushimit të lehonisë, do të heq dorë nga vendi i punës time të deritashme dhe he për he nuk do të punoj. Deri më tani, punëdhënësi im mi ka paguar shtesat e fëmijëve për vajzën tonë. Ish burri im tani më ka njoftuar, se ai tani do të aplikojë vet për shtesat për fëmijë. Dhe gjithashtu ai do që edhe këto t'i zbrësë nga pagesat e mirëmbajtjes. A mund ta bëjë këtë?

Regula Dick: Jo, shtesat për fëmijë nuk duhet të kompensohen kundrejt pagesave për mbështetjen e përkujdesjes për fëmijë. Nga ana tjetër, ish-burri mundet – dhe duhet – të aplikojë për ndihmën e fëmijëve. Kush mund të bëjë të vlefshme të drejtën për shtesa të fëmijëve, rregullohet në ligjin për familje (FamZG). Gjithmonë vetëm njëri prind mund të përfitojë shtesat për fëmijën. Meqenëse ju ishit të punësuar, ju edhe keni marrë kompensimin, sepse si kujdestare e vetme derisa punoni ju edhe e keni këtë të drejtë. Tani pasi do të heqësh dorë nga punësimi fitimprurës, ish burri yt duhet të kërkojë shtesat për fëmijë përmes punëdhënësit të tij. Sidoqoftë, burri juaj i mëparshëm duhet t'i përcjellë këtë pagesë për tek ju dhe nuk mund t'ua zbrët juve ato nga obligimi i mbështetjes financiare për mbajtjen e vajzës suaj. Nëse ai nuk ju përcjellë kompensimin, ju mund të kërkonit nga zyra kompetente e kompensimit që në të ardhmen juve t'ua paguajë drejtpërdrejtë shtesat e fëmijës.

Work, 15 qershor 2018

Puna natën: Cila shtesë më takon mua?

Më herët unë kam punuar përjashtimisht vetëm gjatë natës. Për këtë arsye kam marrë 25% më shumë pagë. Tani punoj rregullisht natën dhe nuk marr më shtesën e pagës. Për këtë unë tani marr vetëm një shtesë prej 10%. Unë nuk e kuptoj pse unë papritur marr një shtesë kohe në vend të një shtese të pagës. A është kjo e drejtë?

Mirjam Brunner: Po. Ligji bën dallimin midis «punës së përkohshme të natës» dhe «punës së vazhdueshme ose të rregullt të natës». Nëse punoni përjashtimisht vetëm gjatë natës, d.m.th. deri në 24 net në vit, sipas Ligjit të Punës, ju do të merrni 25% më shumë pagë. Kështu punëtorët për 24 netët e punuara në vit marrin 125% pagë. Nëse punoni më shumë se 24 netë në vit, nuk do të merrni shtesë page, por një shtesë kohore prej së paku 10%. Për çdo orë që punoni gjatë natës ju do të kreditoheni me të paktën 6 minuta. Meqenëse puna e natës me kohëzgjatje më të gjatë është e dëmshme për shëndetin, këto efekte negative duhet të kompensohen me një shtesë kohore. Për ata që punojnë rregullisht gjatë natës kanë nevojë për më shumë kohë rekreacioni. Shumë Kontrata Kolektive të Punës parashikojnë më shumë sesa shtesat e parapara minimale ligjore. Shtesat e ulëta nuk mund të rregullohen as në Kontratat Individuale të Punës, pasi që minimumi ligjor në asnjë rast nuk duhet të jetë më i ulët.

Work, 17 gusht 2018

Diaspora për zhvillim 2018 Bashkëpunimi sindikalist Zvicër – Kosovë

Gjatë verës së këtij viti u zhvilluan disa aktivitete konkrete që kanë të bëjnë me kontributin e mundshëm të diasporës për zhvillim- bashkëpunimin me vendin amë. Përderisa përpjekjet dhe kontributet tjera karakterizuese të diasporës ishin tuaja se individuale, ai i sindikalistëve shqiptar të Unia nga Zvicër u cilësua me aktiviteti dhe kontributi më i organizuar grupor.



Pamje nga konferenca e majit 2018 në Prishtinë



Hilmi Gashi prezanton përvojat e fushatave sindikaliste

Në Konferencën e organizuar në muajin maj 2018 nga Germin, sindikalistët shqiptarë nga sindikata Unia në Zvicër bashkë me Bashkësinë e Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), zhvilluan punishten ndërshtetërore mbi të drejtën e punës në Kosovë, ku ishte prezent edhe përfaqësuesi i Inspektoratit të Punës të Qeverisë së Kosovës.

Kjo punëtori trajtoi të drejtat e punëtorëve dhe aspektin ligjor rreth zbatimit të ligjit të punës, sigurimin shëndetësor dhe aksidental dhe sigurinë sociale në Kosovë. Me këtë rast përfaqësuesit nga sindikata Unia, Osman Osmani, Ruzhdi Ibrahim, Adelina Muhagjeri, Florim Kadriu, dhe Hilmi Gashi kanë prezantuar edhe disa rekomandime për të përmirësuar organizimin sindikalist në Kosovë.

Shkëmbim për institucionalizim të bashkëpunimit

Ndërsa në ditën e dytë, delegacioni i sindikatës UNIA i përbërë nga Osman Osmani, Hilmi Gashi e Ruzhdi Ibrahim bashkë me kryetarin e BSPK, Avni Ajdini dhe zyrtaren për marrëdhënie ndërkombëtare Dafina Mehaj, shqyrtuan mundësitë e bashkëpunimit në të gjitha fushat e mundshme që kanë të bëjnë me lëvizjen sindikaliste, reformimin, organizimin, fushatat dhe mobilizimit të përgjithshëm sindikalist.

Të dy sindikatat (Unia dhe BSPK) shprehën dëshirën të intensifikojnë bashkëpunimin në fushën e sigurisë/mbrojtjes së shëndetit në punë (SMSHP). Një qëllimi (i përkohshëm) i parë është promovimi i mbrojtjes së punonjësve në Kosovë. Për këtë qëllim, është planifikuar një pako aktiviteti në tre faza për vitin 2018:

Zhvillimi i një projekti të mundshëm në tri faza duke filluar nga:

- Inventari: Mbledhja e të dhënave dhe fakteve me anë të një ose më shumë pyetësorëve (Gusht-Shtator 2018);
- Bazuar në vlerësimin e të dhënave / fakteve të mbledhura nën «1.», do të mund të zhvillojmë një projekt për promovimin e SMSHP në Kosovë (shtator 2018);
- Realizimi i projektit: zbatimi konkret (tetor-dhjetor 2018) i projektit të zhvilluar nën «2.» dhe përkufizimi i aktiviteteve pasuese.

Fuqizimi i lëvizjes sindikaliste më se i nevojshëm
Ndërsa sa i përket fuqizimit të lëvizjes sindikaliste, reformimin, organizimin, fushatat dhe mobilizimit të përgjithshëm sindikalist, që u trajtuan në ditën e dytë, dolën edhe disa nga rekomandimet kryesore që vijnë më poshtë:

Është më se i nevojshëm një reformim i përgjithshëm sindikalist në Kosovë në kushtet e rrethanat e ndryshimeve sistemore nga ato «socialiste» në «kapitaliste», si në vijim;

- Përbalja me krizën sindikaliste dhe problemeve përcjellëse si: zvogëlimin e numrit të anëtarëve, ankorimit të dobët nëpër ndërmarrje, veçanërisht mungesa totale e ankorimit në ndërmarrjet private, ankorimi i dobët nëpër regjione, copëzimi (fragmentarizimi) sindikalist, varësia nga partitë politike (pushteti), integrimi në procesin e privatizimit.
- Nisja e një projekti sindikalist me synime e qëllime të formuluar dhe deklaruar qartë: tejkalimi i copëzimit sindikalist, ndërtimi ndër-profesional dhe ndër-sektorial, ankorim në regjione, organizimi i shkretëtirave (sektorëve të paorganizuar si ndërtimtaria, tregtimi me pakicë, etj.) sindikaliste, rritja e aftësisë mobilizuese, pavarësia politike, fuqizimi i bashkëpunimit me sindikatat e Evropës juglindore dhe në përgjithësi atyre evropiane.

Për të ndjekur këto objektiva pjesëmarrësit u pajtuan të fillojnë përpilimin e një projekti afatgjatë të bashkëpunimit dhe mbështetjes së ndërsjellët sindikaliste dhe aprovimin e tij të mundshëm qysh gjatë këtij viti.

Seminari me Sindikatat e re KEK, FSPE të BSPK-në dhe gazetarinë hulumtuese

Më 30 korrik 2018 në Kosova B, u zhvillua seminari për Mbrojtje dhe Siguri në Pune, në kuadër të projektit të BE-se: «Ngritja e njohurive dhe bashkëpunimit për mbrojtje dhe siguri në punë përmes gazetarisë hulumtuese» me rreth 50 pjesëmarrës nga SR KEK dhe FSPE. Me këtë rast referuan ekspert vendor si Shukrije Rexhepi nga BSPK-ja dhe ata të sindikatës Unia nga Zvicra, Hilmi Gashi dhe Osman Osmani.

Kolegu Hilmi Gashi referoi mbi zhvillimin e suksesshëm të fushatave sindikaliste bazuar në përvojën e sindikatës Unia të Zvicrës, ndërsa O. Osmani prezantoi edhe njëherë tjetër projektin e mundshëm të bashkëpunimit në kuadër të Sigurisë dhe Mbrojtjes së Shëndetit në Punë.

Dafina Mehaj, zyrtare e BSPK-së për marrëdhënie ndërkombëtare



Kontributi i sindikalistëve shqiptarë të Unia në konferencë